



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr.23, datë 25.02.2021

PËR

VIJIMIN E PROÇEDURAVE TË PRISHJES SË DETYRUAR TË 1 (NJË) OBJEKTI BANIMI, PRONË PRIVATE (PALLAT), NDODHUR NË NJËSINË ADMINISTRATIVE NR. 4, DURRËS, NË ZBATIM TË EKSPERTIZËS TË THELLUAR, HARTUAR NGA INSTITUTI I NDËRTIMIT, TIRANË

Në zbatim të Ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjit nr. 45/2019, “Për mbrojtjen civile”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.750, datë 27.11.2019 “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë, i ndryshuar, Aktit Normativ nr.9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore” miratuar me Ligjin nr. 97/2019, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 887, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurës së përshpejtuar për hartimin dhe miratimin e planit të detyruar vendor, si dhe procedurës së miratimit të lejeve të zhvillimit/ndërtimit, në rastet e fatkeqësive natyrore”, dhe sipas relacionit të hartuar nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, me propozim të Zëvendëskryetares së Bashkisë, e cila kryen funksionet e Kryetares së Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I :

1. Vijimin e procedurës të prishjes së detyruar të 1 (një) objekti banimi, pronë private (pallat) ndodhur në Njësinë Administrative nr. 4, në zbatim të ekspertizës të thelluar, hartuar nga Instituti i Ndërtimit Tiranë, sipas tabelës si më poshtë vijon:

PROT./DATË	OBJEKTE	NR. KATE	ADRESA	GIS	KONKLuzion	NJËSIA ADMINISTRATIVE
Nr.Prot.11873/10, dt.21.10.2020, Nr. Prot.Ins.2508, 2580/1, dt.19.10.2020	Kristo Sotiri 18	5 kate	Rruga "Kristo Sotitri", objekti nr.18	22378	Prishje	Nj.Administrative. Nr.4

2. Zëvendëskryetari i Bashkisë, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit dhe Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit ndjekin procedurat për aplikimin, shqyrtimin dhe miratimin e dokumentit për leje ndërtimi (prishjen e objektit të dëmtuar nga fatkeqësia natyrore), sipas parashikimeve të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 887/2019.
3. Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit merr të gjitha masat për ndërhyrjen dhe prishjen e objektit të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi.
4. Me qëllim njoftimin e banorëve dhe palëve të interesuara, vendimi publikohet në faqen zyrtare të Bashkisë Durrës, si dhe afishohet në këndin e njoftimeve pranë Njesisë Administrative nr. 4.
5. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Zëvendëskryetari i Bashkisë, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit Vendor Durrës dhe Drejtoria e Kabinetit.
6. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar).

KRYETARI KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 25.02.2021



KRISTO SOTIRI 18


22378

DIBARËS

REPUBLIKA E SHQ

2116/112

2



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 173 prot.
16



Durrës, më 02.03 .2021

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

KËSHILLIT BASHKIAK

DURRËS

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr. 23 datë 25.02.2021 “Për vijimin e procedurave të prishjes së detyruar të 1 (një) objekti banimi, pronë private (pallat), ndodhur në Njësinë Administrative Nr. 4 Durrës, në zbatim të ekspertizës së thelluar hartuar nga Instituti i Ndërtimit, Tiranë”.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

ROLAND NASTO

